



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Endrit Bakiu** me datë **10.12.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit personal “*arrest në burg*” të caktuar nëpërmjet vendimit nr. 70, dt. 23.06.2023 ndaj shtetasit Endrit Bakiu”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Erjon Çela, Erjon Bani dhe Rudina Palloj, bazuar në nenet 112 dhe 261/1/c të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **702**, datë **12.12.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit (të pandehurit) **Endrit Bakiu**.
2. Konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit “*arrest në burg*”, e caktuar ndaj të pandehurit **Endrit Bakiu** me vendimin nr. 70 dt. 23.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak se kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit të caktuar me vendimin nr. 72 dt. 05.12.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
3. Urdhërohet liri i menjëhershëm i të pandehurit **Endrit Bakiu** nga masa e sigurimit “*arrest në burg*” nëse nuk mbahet për ndonjë vendim tjetër mase siguri personal shtrëngues “*arrest në burg*”, apo vendim dënimi me burgim të formës së prerë.
4. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, dhe policia gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 12.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar